



**Udhëzime për zbatimin e detyrimeve të operatorëve celularë
për Roamingun me Ballkanin Perëndimor**

(Udhëzues për zbatimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.21-24, datë 24.06.2019)

Hyrje

Këto udhëzime janë përgatitur për zbatimin nga operatorët celularë të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.21-24, datë 24.06.2019, për rregullimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, sipas “*Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor*” (këtu e në vijim RRA WB6), të nënshkruar në Beograd më 4 Prill 2019 nga ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (këtu e në vijim BP): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia.

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 6 të RRA WB6, këto udhëzime janë përgatitur duke i referuar dokumentit të BEREC, *BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on wholesale access and separate sale of ser-vices)*, duke i përshtatur në kontekstin e marrëveshjes rajonale të roamingut (RRA WB6), dhe shërbejnë kryesisht për zbatimin e fazës tranzitore të roamingut RLAH+ më 1.07.2019-30.06.2021. Shumica e këtyre udhëzimeve janë pjesë dhe dokumentit “Rregullimi i tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor”, miratuar më 24.06.2019.

Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 6 të RRA WB6, detaje/udhëzime për aplikimin e modelit RLAH që fillon më 1.07.2021 si dhe për Fair Use Policy (FUP) për RLAH do të jepen gjatë vitit 2020 nga AKEP pas miratimit të aktit përkatës që transponon Rregulloren implementuese të BE 2016/2286 për FUP dhe udhëzimeve përkatëse të BEREC.

Objekti dhe fusha e veprimit

“Thirrje roaming të rregulluara” përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO të RSH apo operatorëve celularë të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në RSH, të cilat janë thirrje dalese apo thirrje hyrese drejt apo nga BP dhe/ose RSH.

“SMS roaming të rregulluara” përfshin SMS dërguara ose të marra nga pajtimtari i MNO i RSH apo operatorëve celularë të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në MNO në RSH, të cilat janë SMS dalese apo hyrese drejt apo nga BP dhe/ose RSH.

“Shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming” përfshin shërbimin e romaingut që mundëson përdorimin e aksesit në Internet të pajtimtarit të MNO të RSH apo operatorit celulare të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në MNO në RSH. Shërbimi i rregulluar i të dhënave nuk përfshin transmetimin apo marrjen e thirrjeve të rregulluara roaming apo SMS-vem por përfshin transmetimin dhe marrjen e mesazheve MMS.

- 1.** Thirrje të rregulluara roaming përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO të RSH gjatë roamingut në operatorin e rrjetit vizitues në BP, të cilat janë thirrje dalese drejt apo thirrje hyrese nga RSH dhe/ose BP, pjesë e marrëveshjes së roamingut. Pra në këto thirrje nuk përfshihen p.sh thirrjet e një pajtimtari të MNO të RSH drejt vendeve të BP kur ai ndodhet në Shqipëri (pasi nuk është në roaming në këtë rast), apo thirrjet e pajtimtarit kur është në roaming në një vend të BP që kanë destinacion apo janë origjinuar nga një shtet tjetër i ndryshëm nga BP. I njëjti sqarim vlen dhe për SMS-të. Ndërsa shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming përfshin përdorimin e Internetit të pajtimtarit të MNO të RSH në roaming në një rrjet MNO të vizituar në vendet e tjeat të BP, pavarësisht teknologjisë së përdorur 2G, 3G apo 4G etj.

Thirrjet e rregulluara roaming përfshijnë vetëm thirrjet e origjinuara dhe terminuar në rrjetet celulare në Shqipëri dhe BP. Përfshirja e thirrjeve drejt rrjeteve fikse në këtë periudhë pa rregulluar më parë tarifën e terminimit të këtyre thirrjeve do të përbënte ofrim me humbje të këtyre thirrjeve për operatorët celularë. AKEP dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera të BP do të trajtojnë këtë çështje në një kohë të mëvonshme.

Tarifat vendase me pakicë si bazë për tarifatat me pakicë roaming në BP sipas RLAH+ dhe RLAH

- 2.** Baza për tarifatat roaming në modelet RLAH dhe RLAH+ do jone tarifatat dhe sistemi tarifor i aplikuar për konsumin e shërbimeve brenda vendit. Në rastin e tarifave për njësi të thirrjeve, SMS-ve dhe Internetit, gjatë fazës tranzitore RLAH+ operatorët kanë të drejtë të aplikojnë një tarifë shtesë (ekstra) mbi tarifën përkatëse brenda vendit, por kjo tarifë ekstra nuk duhet të jetë më e madhe se tarifatat përkatëse maksimale me shumicë sipas periudhës përkatëse. Njëkohësisht tarifa totale roaming retail, tarifa brenda vendit (domestic retail) + Tarifën Ekstra, duke filluar nga 1 Korrik 2019, nuk duhet të tejkalojë tavanet e përcaktuara 0.19 Euro/min për thirrje dalëse, 0.04

euro/min për thirrje hyrëse, 0.06 Euro/SMS dhe 0.18 euro/MB (pa TVSH). Tabela e mëposhtëme paraqet tarifatat ekstra (shitesat) maksimale mbi tarifatat vendase dhe tavanet për tarifatat totale maksimale roaming retail sipas RLAH+ të shprehur në Lek me TVSH.

TABELA 1: TAVANET PËR TARIFAT STANDARDE (PAY AS YOU GO/OUT OF BUNDLE) ME PAKICË TE ROAMINGUT ME BP RLAH+

Periudha	Thirrjet dalëse (Lek/min)	Thirrjet Hyrëse (Lek/min)	SMS të dërguar (LEK/SMS)	Transmetimi i të dhënave (Lek/MB)
1.07.2019- 30.06.2020	Domestic Retail + 7.50	6.00	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail + 3.75
1.07.2020- 30.06.2021	Domestic Retail + 7.50	3.75	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail + 2.25
Tavani (1.07.2019- 30.06.2020)	28.50	6.00/3.75	9.00	27.00

Shënim: Vlerat në Lek me TVSH, Kursi i këmbimit i përdorur 1 Euro=125 Lek

- Tabelat e mëposhtme paraqesin tarifatat aktuale standarte të roamingut me BP, tarifatat aktuale brenda vendit dhe tarifatat e reja maksimale retail për roamingun në fazën tranzitore RLAH+.

TABELA 2: NDRYSHIM I TARIFAT STANDARDE TE ROAMINGUT ME BP (RLAH+)

Tarifatat aktuale standarte (pay as you go) te roamingut me BP (Prill 2019)

Operatori	Min dalëse	Min hyrëse	SMS	Internet
	(Lek/Min)	(Lek/Min)	(Lek/SMS)	(Lek/MB)
Vodafone Albania	215	175	65	365
Telekom Albania	140	100	20	60
Albtelecom	25	25	10	20

Shënim: Tarifatat në Lek me TVSH

Tarifat maksimale me pakicë (pay as you go/out of bundle) roaming sipas RLAH+ me BP

(Faza e pare 1.07.2019-30.06.2020)

Operatori	Min dalëse	Min hyrëse	SMS	Internet
	(Lek/Min)	(Lek/Min)	(Lek/SMS)	(Lek/MB)
Vodafone Albania	28.50	6.00	9.00	27.00
Telekom Albania	28.50	6.00	9.00	27.00
Albtelecom	28.50	6.00	9.00	27.00

Sbënim: Tarifat në Lek me TVSH

Aplikimi i RLAH+ për përdoruesit e paketave/bundles brenda vendit

3. Për përdoruesit me kontratë dhe me parapagim që përdorin paketa tarifore brenda vendit që përfshijnë njësi si minuta, SMS, apo MB, aplikimi i RLAH nënkupton që pajtimtari mund të konsumojë njësitë e përfshira në paketë sikur të ishte në Shqipëri dhe njësitë e konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Pas mbarimit të njërive të paketës pajtimtari tarifohet me tarifën përkatëse për njësi sikur të ishte brenda vendit. Për shërbimin e Internetit operatori ka të drejtë të aplikojë FUP (shiko sqarimin në Hyrje).

Gjatë regjimit RLAH+ operatori ka të drejtë të aplikojë një Tarifë ekstra, duke tarifuar njësitë e konsumuara në roaming me tarifë ekstra maksimale sa tarifën përkatëse me shumicë dhe këto njësi të konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Psh. për cdo pajtimtar që ka një paketë (bundle) me minuta, SMS dhe Internet të përfshira në pagesën fikse, operatori gjatë RLAH+ ka të drejtë të aplikojë tarifa shtesë për njësitë e përfshira në paketë dhe të konsumuara në roaming në BP, dhe tarifën shtesë maksimale për fazën e parë që fillon më 1 Korrik 2019 janë **7.5 lek/minute per thirrje dalese, 6 lek/Minute thirrje hyrese, 3 Lek/SMS të derguar dhe 3.75 Lek/MB** (te gjitha keto tarifa me TVSH). Per shembullin e dhene ne tebe, pajtimtari do te duhet te paguaje 2430 Lek shtese per konsumin ne roaming gjate fazes tarzitore RLAH+ per 50 minuta dalëse, 25 minuta hyrëse, 10 SMS të dërguara dhe 500 MB të konsumuar në roaming në BP, mbi tarifën fikse që ka paguar për ofertën/pajtimin mujor.

Në rast të përdoruesve me parapagim që kanë aktivizuar ofertë/bundle, ata duhet të kenë kredite në llogarinë e tyre, dhe shpenzimet shtesë i zbriten nga këto kredite sipas shpenzimeve të matura me tarifën e cituar, dhe sasitë e konsumuara në roaming i zbriten nga sasitë e përfshira në paketën brenda vendit.

TABELA 3: SHEMBULL I APLIKIMIT TË RLAH+ PËR BUNDLE

	Minuta Dalese	Minuta Hyrese	SMS	Internet (MB)
Sasite e perfishira ne pakete	1000	pa limit	500	1000
Sasite e konsumuara ne Roaming	50	25	10	500
Tarifa maksimale shtesë RLAH+	7.50	6.00	3.00	3.75
Kosto Shtese (Lek me TVSH)	375	150	30	1875
Sasite e mbetura	950	pa limit	490	500

Shënim: Tarifat/ Shpenzimet ne Lek me TVSH

Tarifa fikse periodike roamingu me BP

4. Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa tarifore roaming me një tarifë fikse ditore ose çdo tarifë tjetër fikse roaming periodike dhe që përmbajnë një volum të caktuar të shërbimeve roaming të rregulluara në BP. Këto paketa duhet të jenë si një opsion/alternative për klientët e tyre gjatë periudhës tranzitore përveç tarifave të rregulluara roaming. Kjo do të thotë që këto tarifa periodike fikse roaming nuk mund të jenë opsioni i vetëm tarifor i disponueshëm për pajtimtarët roaming.
5. Një tarifë fikse periodike roaming ne përputhje me përcaktimet për RLAH+, mund të mos konsiderohet si tarifë alternative, me kushtin që konsumi i plotë i njësive të përfshira në paketë (pagesën fikse) rezulton në një tarifë për njësi të shërbimeve të rregulluara në roaming (thirrje, SMS dhe data), e cila nuk tejkalon shumën e tarifës vendase dhe me pakicë me tarifën shtesë maksimale sipas përcaktimeve të RLAH+. Për të bërë këtë vlerësim duhet të kryhen llogaritjet përkatëse nëse tarifa fikse është në përputhje me rregullat për RLAH+ Psh. Një paketë që përmabn (Guildeline 17 i dokumnetit te BEREC 2016).

Për shembull, nga 1 Korrik 2019 deri më 30 qershor 2020, një paketë tarifore roaming periodike fikse që përfshin 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB mund të tarifohet me një tarifë ekstra maksimale prej 513 Lek (25 minuta * 7.5 Lek + 25 minuta thirrje të marra * 6 Lek + 25 SMS * 3 Lek + 25 MB * 3.75 Lek) mbi tarifën e paketës brenda vendit. Për tarifën e paketave bundle, kjo do të thotë një tarifë fikse roaming ditore deri në 513 Lek për sasitë e cituara apo më të mëdha do të ishte në përputhje me fazën e parë të RLAH+ me BP. Për tarifën vendase të matur për njësi, një tarifë fikse periodike roaming prej 513 lekë plus çmimin

brend vendit retail për 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB kosniderohet në përputhje me RLAH+.

Gjithsesi AKEP konsideron keto si paketa alternative te rregulluara qe duhet te ofrohen paralelisht me tarifat dhe sistemin tarifor RLAH+, dhe pajtimtari te zgjedhe me vullnet te lire paketen e preferuar.

Paketa tarifore alternative

6. Tarifa apo paketa tarifore roaming alternative janë ato tarifa/paketa që ofrohen paralelisht me tarifat e rregulluara roaming me BP. Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa alternative roaming me BP, por tarifat dhe tarifimi default/automatik do jetë sipas përcaktimeve të cituara më sipër (RLAH dhe RLAH+). Nëse pajtimtari dëshiron një paketë alternative roaming ai duhet të informohet nga operatori për mundësinë që ka për të konsumuar sipas RLAH apo RLAH+. Pra zgjedhja e pajtimtarit duhet të jetë me vetdije në kushte që ka informacion te plote për tarifat sipas RLAH dhe RLAH+. Në fazën RLAH+ këta pajtimatrë mund të vijojnë të përdorin tarifat altarnetive, me kushtin që ata të informohen në mënyrën e duhur për tarifat e rregulluara roaming me BP në kohën që hyjnë në një vend të BP. Informimi për tarifat e rregulluara roaming me BP mund te kryhet me SMS, në faturën mujore, duke përshekruar natyrën e shërbimeve dhe tarifave të rregulluara roaming që pajtimatri ka hequr dorë nga përdorimi për roaming në BP. Në rats se pajtimatri dëshiron të transferohet nga tarifa aletarnative në atë të rregulluar veprohet sipas përcaktimeve të Vendimeve të AKEP për roamimgun me BP.

Step charging

7. Njësitë e konsumuara të thirrjeve gjatë roamingut në BP duhet të tarifohen për sekondë. Operatori ka të drejtë të aplikojë kohë minimale tarifimi jo më të gjatë se 30 sekonda, dhe më pas në njësi sekonde. Tarifimi për SMS duhet të jetë për njësi SMS (1 SMS=140 karaktere). Tarifimi i të dhenave në roaming duhet të jetë në kb. Ky mekanizm tarifimi është i implementueshëm, pasi operatori në RSH merr informacionin nga file TAP nga operatori i rrjetit të vizituar në BP, i cili ka këto detyrime për tarifim të shërbimeve ëholesale. Ky informacion tarifimi në ëholesale i operatorit më pas përdoret dhe procesohet nga operatori vendas për tarifimin retail të pajtimtarit, duke mos ndryshuar mënyrë e tarifimit dhe matjes të njesive të konsumura në roaming, pavarësisht se si është mekanizmi i tarifimit për konsumin brenda vendit.

Mundësitë teknike në sistemet e faturimit

Gjatë procesit të këshillimit publik dhe takimeve të AKEP me operatorët celularë për roamingun rajonal, operatorët celularë janë shprehur ata nuk kanë mundësitë teknike në sistemet e tyre të faturimit për të bërë implemetimin e plotë të RLAH+ nga data 1 Korrik 2019 sipas Udhëzimit 3 më sipër për pajtimtarët (me paspagim dhe me parapagim) që përdorin brenda vendit paketa apo bundle me njësi (minuta, SMS dhe GB) të përfshira në paketë: aplikimi i tarifës ekstra për njësitë e konsumuara në roaming në BP dhe zbritja e këtyrë njesive nga paketa brenda vendit (shiko Udhëzim 3 më sipër).

Ky shqetësim është ngritur dhe nga operatorët celularë në vendet e tjera të BP. Në diskutimet e Grupit Koordinues të rregullatorëve për roamingun në BP për marrëveshjen RRA WB6, në takimin në Podgoricë më 31 Maj 2019 u ra dakort që duke filluar nga 1 Korrik 2019 por jo më vonë se deri më 31 Dhjetor 2019, operatorët celularë që nuk kanë këtë mundësi teknike të përdorin si referencë për tarifat brenda vendit (domestic price) tarifën (të ardhurën) mesatare për njësi të thirrjeve, SMS dhe MB brenda vendit dhe mbi këtë ata mund të aplikojnë tarifën ekstra (surcharge). Tarifa mesatare për njësi mund të llogaritet nga raporti i të ardhurave retail për thirrje/SMS/MB me sasi të përkatëse për vitin 2018.

Bazuar në sa më sipër, me qëllim akomodimin e vështirësive teknike të operatorëve celularë për RLAH+ duke filluar nga 1 Korrik 2019, AKEP ka bërë llogaritjet për të ardhurat/tarifat retail mesatare për njësi për thirrje dalëse, SMS dhe MB të operatorëve celularë për vitin 2018 duke përfshirë sqarimin e mëposhtëm për periudhën 1.07.2019-31.12.2019.

8. Në raste të justifikuara të pamundësisë teknike për implementimin e plotë të RLAH+ në sistemet e billingut retail për përdoruesit me parapagim dhe paspagim të paketave/bundles sipas Udhëzimit 3 më sipër, duke filluar nga data 1 Korrik 2019 por jo më vonë se deri më 31.12.2019, operatori celular mund të ofrojë tarifa për njësi dhe paketa të dedikuara për këta përdorues gjatë roamingut në BP, ku si tarifë bazë reference brenda vendit (domestic reference price) të përdoren vlerat e tabelës së mëposhtme, dhe tarifa totale retail roaming për njësi (Domestic price + Surcharge) të mos jetë më e lartë se **11.16 lek/minutë** për thirrje dalëse, **6.00 lek/minutë** për thirrje hyrëse, **4.2 lek/SMS** të dërguar dhe **4.02 lek/MB** (të gjitha tarifat me TVSH). Në këtë rast sasi të konsumuara në roaming **nuk** i zbriten sasive të përfshira në paketë si në Udhëzim 3.

TABELA 5: ZGJIDHJE ALTERNATIVE PËR TARIFAT BRENDA VENDIT REFERENCE DHE TARIFAT MAX RETAIL ROAMING PËR RLAH+ PËR PËRDORUESIT ME PAKETË/BUNDLE AKTIVE (1.07.2019-31.12.2019)

	Tarifa bazë referencë brenda vendit për njësi (Domestic Reference Average price per Unit)	Tarifa shtesë (Surcharge)	Tarifa maksimale totale roaming (Max Total Retail Roaming Tariff)
Thirrje dalese(min)	3.66	7.50	11.16
Thirrje Hyrese(min)	0.00	6.00	6.00
SMS dalese	1.20	3.00	4.20
Data (MB)	0.266	3.75	4.02

Shënim: Tarifat në Lek me TVSH

Operatorët që ndeshen me vështirësi teknike të referuara në Udhëzim 8 më sipër duhet të dërgojnë në AKEP argumentat për këto vështirësi si dhe masat e marra për ndryshimet e nevojshme në sistemet e billingut dhe afatet e realizimit të tyre që nuk duhet të jenë më vonë se 31.12.2019.

AKEP do të vlerësojë argumentat për këto veshitirësi dhe do të marrë masat e duhura sipas ligjit 9918 për moszbatimin e detyrimeve sipas Vendimeve të KD të AKEP me nr.21-24, datë 24.06.2019 dhe këtyre udhëzimeve.

Përfundim:

Tabela më poshtë përmbledh tarifatat maksimale për RLAH+ sipas udhëzimeve të dhëna në këtë dokument.

Tabela 6: Tavanet e tarifave për RLAH+ (1.07.2019-31.12.2019)

	Paketë/Bundle (Udhëzimi 3)	Paketë/bundle (Udhëzimi 8)	Pay as You Go/Out of Bundle (Udhëzimi 2)
Thirrje dalese (Lek/min)	7.50	11.16	28.50
Thirrje Hyrese (Lek/min)	6.00	6.00	6.00
SMS dalese (Lek/SMS)	3.00	4.20	9.00
Data (Lek/MB)	3.75	4.02	27.00
Shënime	Sasitë e konsumuar në roaming zbriten nga paketa aktive brenda vendit (përdorues parapagim/paspagim me bundle aktive)	Sasitë e konsumuar në roaming nuk zbriten nga paketa aktive brenda vendit (përdorues parapagim/paspagim me bundle aktive) Aplikohet vetëm për pamundësi të justifikuar teknike të zbatimit të Udhëzimit 3 dhe më 1.07.2019-31.12.2019	Aplikohet për përdoruesit që nuk kanë paketë aktive brenda vendit dhe/ose kur kanë mabruar nëjstitë përkatëse të paketës.

Sbënim: Tarifatat në Lek me TVSH

- *Max 1 (Udhëzimi nr.3 i AKEP) do të aplikohet nga Vodafone Albania duke filluar nga data 1 Korrik 2019, dhe është operatori i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që mundëson nga data 1.07.2019 përdorimin e paketave brenda vendit (me parapagim dhe paspagim) edhe në roaming në Ballkanin Perëndimor, sipas modelit të aplikuar në BE. Njësitë (minuta/SMS/MB) që përdoren në roaming në BP, tarifohen sipas vlerave maksimale më sipër, dhe këto njësi i zbriten njësitë përkatëse të përfshira në paketën që keni aktive brenda vendit. Pra përdorimi Fol si n'shpi edhe me paketën me parapagim apo paspagim si modeli i BE RLAH+.*
- *Max 2 (Udhëzimi nr.8 i AKEP) do të aplikohet nga Telekom Albania dhe Albtelecom për një periudhë tranzitore maksimumi deri në 31 Dhjetor 2019, për të kaluar më pas në Max 1. Gjatë kësaj periudhe, njësitë (minuta/SMS/MB) që përdoren në roaming në BP, tarifohen sipas vlerave maksimale më sipër (Max 2), por këto njësi **nuk i zbriten** njësitë përkatëse të përfshira në paketën që keni aktive brenda vendit.*

- *Max 3 (Udbëzimi nr.2 i AKEP) aplikohet nga të tre operatorët për përdoruesit me parapagim dhe me kontratë që nuk kanë një paketë aktive brenda vendit, ose kur kanë mbaruar njësitë e përfshira në paketë.*
- *Në mënyrë që përdoruesit me parapagim, që kanë aktivizuar ofertë/ bundle, të përfitojnë nga tarifat e Max 1 dhe Max 2, përveç ofertës ata duhet të kenë dhe kredite në llogarinë e tyre me parapagim, dhe shpenzimet shtesë i zëbrihen nga këto kredite sipas shpenzimeve të matura me tarifat e cituara.*
- *Tarifat e mësipërme janë tavane të përcaktuara nga AKEP në vendimet dhe udhëzimet e cituara më sipër, dhe operatorët celularë aktualisht kanë njoftuar se do ofrojnë dhe tarifa më të lira se këto tavane, si dhe paketa të tjera të favorshme për roaming në Ballkanin Perëndimor dhe AKEP rekomandon përdoruesit të komunikojnë/marrin informacionin e duhur për këto tarifa nga operatori përkatëse përpara se të vizitojnë dhe përdorin roaming në këto vende.*
- *Te gjitha tarifat janë në Lek me TVSH.*